

Prof. Dr. Emil Lafe

## NJË MONOGRAFI PËR ZHVILLIMIN E KULTURËS SHQIPTARE ME NDIKIME ORIENTALE

Mbi librin e Nehat Krasniqit, "Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare". Instituti Albanologjik. Prishtinë, 2017

Ky libër i Prof. Dr. Nehat Krasniqit, hulumtues i njohur i periudhës osmane në historinë dhe kulturën e shqiptarëve, përfaqëson një monografi të mirëfilltë shkencore për temën përkatëse. Pasqyra e lëndës tregon se autori e ka rrokur temën në vështrim të gjerë: Kreu I - Sfondi historik i ndikimeve orientale në kulturën shqiptare (f. 35-94); Kreu II - Bazat ekonomike-shoqërore dhe politike të zhvillimit të kulturës shqiptare në fillim të shek. XVIII (f. 95-186); Kreu III - Roli i fisnikërisë vendëse në zhvillimin e kulturës shqiptare me ndikime orientale islame (f. 187-223); Kreu IV - Themelimi i institucioneve arsimore, edukative dhe kulturore (f. 225-260); Kreu V - Gjuha letrare shqipe dhe gjuhësia shqiptare në krijimtarinë Alamiado (f. 261-278); Kreu VI - Letërsia shqiptare me ndikime orientale (f. 279-422); Kreu VII - Urbanistika dhe arkitektura (f. 423-454); Kreu VIII - Kultura popullore me ndikime orientale (f. 455-477); më tej vijnë përfundimet shqip dhe anglisht (f. 479-507); Burimet dhe literatura (f. 509-538); Treguesi i emrave të personave (f. 539-575).

Vepra është fryt i një pune studimore të kujdesshme shumëvjeçare në dhjetëra vepra e artikuj të cituar në pjesët e saj dhe gjithashtu i hulumtimeve nëpër arkiva, ku ruhen dorëshkrime të vyera që lidhen me temën. Për këtë dëshmon edhe bibliografia shumë e pasur prej 30 faqesh, po ashtu edhe treguesi i emrave prej 37 faqesh në fund të punimit. Vepra ka edhe karakterin e një sinteze e të një përgjithësimi të studimeve dhe njohjeve të deritanishme në këtë fushë. Vetë autori shprehet se në veprën e tij paraqitet në vija të përgjithshme kultura shqiptare me frymë orientale islame, sepse një studim shterues i kësaj teme është ende i parakohshëm. Kultura shqiptare me ndikime orientale islame

ka mbetur si diçka anësore në interesat e historiografisë shqiptare dhe të albanologjisë përgjithësisht, duke u lënë të trajtohet si trashëgimi kulturore turke. Autori vlerëson se një qëndrim i tillë e ka varfëruar dhe dëmtuar vetë kulturën kombëtare shqiptare dhe njëherësh e ka mjegulluar kujtesën kombëtare shqiptare. Prandaj libri i tij duhet parë si një përpjekje për ta tejkaluar këtë gjendje.

Në kreun I, II dhe III (gati gjysma e librit) paraqitet dhe shpjegohet sfondi historik dhe bazat ekonomike, shoqërore e politike në të cilat rrodhi procesi i ndikimit të kulturave orientale në kulturën e viseve shqiptare me karakteristikat e tij; më tej në kreun IV jepet një pasqyrë e përhapjes, gjendjes dhe rolit të institucioneve arsimore-edukative dhe kulturore të themeluara nga shteti osman. Në vijim, studimi trajton kryesisht elemente të kulturës shpirtërore dhe institucionet që lidhen me të. Për sa i takon gjuhës shqipe, autori me të drejtë është përqendruar te shqipja e shkruar dhe më për së afërmi te autorët që shkruan shqip me alfabetin arab (autori ka adoptuar termin "*alamiado*" për këtë lloj letërsie të quajtur edhe letërsi e bejtexhinjve) dhe që kanë qenë të formuar si njohës të botës e kulturave orientale islame. Ai nisat nga parimi se nëpërmjet hulumtimit të marrëdhënieve gjuhësore mund të rindërtohet në njëfarë mënyre historia e marrëdhënieve kulturore. Me interes të veçantë për gjuhësinë shqiptare është pjesa e dytë e këtij kreu me titullin "Veprat leksikografike e gramatikore dhe autorët e tyre". Mendoj se kreu më i thelluar i studimit është ai ku trajtohet letërsia shqiptare me ndikime orientale (kreu VI). Pjesa e parë e kreut bën fjalë për letërsinë e divanit dhe përfaqësuesit e saj. Si letërsi shqiptare e divanit vështrohet "*letërsia e krijuar nga shqiptarë të ngritur intelektualisht nën ndikimin e drejtpërdrejtë të kulturës dhe qytetërimit islam*" (f. 281). Mjedisi ku u zhvillua letërsia e divanit kanë qenë oborret e qeveritarëve (pashallarëve) lokalë, pranë të cilave u mblodh një elitë intelektuale shqiptare sipas shembullit të pallatit të sulltanit. Karakteristikë dalluese e kësaj letërsie është gjuha e mbingarkuar me orientalizma dhe përdorimi i figurave e simboleve tipike për letërsitë orientale islame, sidomos për letërsinë perse. Llojet poetike janë gjithashtu ato të letërsisë perde: gazeli, kasideja, mesnevia, rubaia, ilahia etj. Është me interes vëzhgimi i autorit, duke u mbështetur edhe te një studim i orientalistit skocez Elias John Wilkinson Gibb (botuar në vitin 1902), se në letërsinë shqiptare të divanit dalin

aty-këtu elemente të tilla që e kualifikojnë atë edhe si refleksion i shpirtit krijues evropian. Në pjesën ku flitet për përfaqësuesit e letërsisë shqiptare të divanit autori ka renditur 35 emra, për të cilët ka sjellë të dhëna rreth jetës e veprës poetike. Pjesa e dytë e kreut për letërsinë me titull “Letërsia shqipe alamiada dhe përfaqësuesit e saj” bën fjalë për atë letërsi që është njohur edhe si letërsi e bejtexhinjve ose letërsi e shkruar me alfabetin arab. Për përshtatshmërinë e termit “*alamiada shqiptare*” dhe për karakterin e asaj letërsie të quajtur kështu, dihet se ka dhe natyrisht do të ketë diskutime. Autorit i ka shpëtuar pa shfrytëzuar kumtesa e studiuesit Nexhip Alpan “Ndikimet e gjuhës dhe të letërsisë turke në gjuhën dhe letërsinë shqipe”, e mbajtur në Konferencën e Dytë të Studimeve Albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut (Tiranë, 12-18 janar 1968) dhe diskutimi polemizues i Prof. Androkli Kostallarit lidhur me këtë kumtesë (të dyja të botuara në vëllimin “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”. Tiranë, 12-18 janar 1968. III. *Materiale të Seksionit të shkencave filologjike*. Universiteti Shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1970). Ajo letërsi u lëvrua nga një shtresë e shkolluar në medresetë e viseve shqiptare ose në qendra të tjera arsimore e kulturore të Perandorisë Osmane. Vështrimi i përgjithshëm për këtë dukuri letrare, për zanafillën, hulumtimin, tipologjinë dhe vlerësimin e saj sjellin ide e trajtime të reja. Në pjesën ku flitet për përfaqësuesit e letërsisë shqiptare të divanit, autori ka renditur 37 emra, për të cilët ka sjellë të dhëna rreth jetës e veprës poetike. Dy krerët e fundit, për urbanistikën e arkitekturën dhe për ndikimet orientale në kulturën popullore, e plotësojnë më së miri vështrimin e hapur të temës së studimit. Libri përfaqëson një kontribut me vlerë të veçantë për historinë e kulturës shqiptare, e sidomos për prurjet nga bota orientale islame. Kjo veper u nderua me çmimin e parë në konkursin e AIITC për vitin 2018.